



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

Udhërrëfyesi i Kosovës për rininë, për paqen dhe për sigurinë

Preambula

Ne, të rinjtë e Kosovës, me prejardhje etnike të ndryshme dhe të bashkuar nga aspirata jonë për të çuar përpara agjendën për rininë, për paqen dhe për sigurinë,

Këtu, në Asamblenë e parë të Kombeve të Bashkuara mbi rininë në Kosovë që u organizua më 28-29 qershor 2017 në Prishtinë,

Duke pranuar faktin se rinia e Kosovës përbën 2/3 e popullsisë,

Duke rikujtuar dhe duke qenë të inspiruar nga Rezoluta vendimtare e Këshillit të Sigurimit të KB-së 2250,

Duke pranuar rolin e iniciativave të drejtuara nga rinia në përpjekjet për arritjen e paqes afatgjate,

Ju bëjmë thirrje Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës të ndërmarrin masa specifike në fushat vijuese,

Dhe të zotohen se do të përfshihen në mënyrë aktive në përpjekjet e përbashkëta për arritjen progresive të këtyre rekomandimeve.

A. Pjesëmarrja

1. Të sigurohet buxhet për rininë në nivelin komunal dhe qendror.
2. Të përfshihen përfaqësuesit e rinisë në takimet qeveritare për çështjet që lidhen me të rinjtë në Kosovë.
3. Të fuqizohen strukturat rinore të vendimmarrjes në Kosovë, përkatësisht Këshilli qendror për veprime rinore dhe këshillat lokale për veprime rinore me rritjen e transparencës së tyre, me rritjen e përkrahjes komunale dhe me zgjidhjen e statusit ligjor në mënyrë që ato të dallohen nga OJQ-të.
4. Të sigurohet bashkëpunim në mes të këshillave për veprime rinore të themeluara më parë në nivelin qendror dhe lokal, dhe këshillave lokale për veprime rinore të posa themeluara në veri të Kosovës, për të fuqizuar kapacitetin e tyre dhe bashkëpunimin rinor ndëretnik në Kosovë.
5. Të sigurohet që burrat dhe gratë e reja nga të gjitha komunitetet të përfaqësohen në këshillat për veprime rinore lokale dhe qendrore në mënyrë të balancuar.



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

6. Të sigurohet që çdo komunë në Kosovë të ketë një qendër rinore funksionale, në pajtim me Ligjin e Kosovës për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë (2009).
7. Të sigurohet që çdo komunë në Kosovë, pavarësisht nga përbërja etnike, të ketë transport publik të arsyeshëm në dispozicion për në Prishtinë dhe nga Prishtina, si parakusht për qasje në objektet e arsimit të lartë.
8. Të fuqizohen dhe të zhvillohen më tej programet për fuqizimin e rinisë që krijojnë kushte lehtësuese për pjesëmarrjen e rinisë në jetën qytetare, ekonomike dhe politike, me fokus të fuqishëm në bashkëpunimin rinor ndëretnik.
9. Të përkrahet sipërmarrësia e të rinjve dhe fillimi i bizneseve përmes zvogëlimit të taksave dhe mikro-kredive.
10. Të rritet përkrahja financiare dhe institucionale për iniciativat e drejtuara nga rinia që ndodhen në Kosovë, veçanërisht për ata që e rrisin bashkëpunim rajonal.
11. Të fuqizohen dhe zhvillohen më tej programet që mbështesin përfshirjen e rinisë në shoqërinë civile dhe në iniciativa për punë vullnetare.
12. Të sigurohet implementimi i Udhëzimit administrativ për punë vullnetare të të rinjve në Kosovë lidhur me njohjen e përvojës vullnetare ndaj përvojës në punë, ndër të tjera, përmes informimit të sektorit privat dhe institucioneve arsimore për këtë dispozitë.
13. Të sigurohet që djemtë dhe vajzat e reja, veçanërisht ato që janë nga viset rurale, të kenë mundësi të barabarta të marrin pjesë në proceset shoqërore, ekonomike dhe politike.
14. Të rritet numri i tregimeve pozitive dhe të promovohet bashkëpunimi i suksesshëm në mesin e të rinjve nga grupet e ndryshme etnike në Kosovë dhe në Ballkanin perëndimor si i tillë, përmes kontakteve personale dhe platformave përmes internetit.
15. Të fuqizohet bashkëpunimi rajonal i të rinjve në Ballkanin perëndimor përmes shkëmbimit të të rinjve, kampeve të paqes dhe iniciativave të përbashkëta, në mes tjerash, përmes qendrës së porsaformuar rajonale për bashkëpunim rinor.

B. Parandalimi

16. Të fuqizohet përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe komunal, ashtu që në mënyrën më të mirë të krijohen politika kundër dhunës ndaj të rinjve, dhe të sigurohet përfshirje e balancuar gjinore në këto procese e grave dhe e burrave të rinj me prejardhje të ndryshme etnike.



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

17. Të njihet puna e grupeve joformale rinore në parandalimin e dhunës kundër/në mes të personave të rinj, dhe të përkrahen këto iniciativa me ndarjen e hapësirave për zhvillimin e tyre në çdo komunë, për shembull, në bazë të qendrave rinore.
18. Të rriten partneritetet në mes të grupeve rinore joformale, OJQ-ve të udhëhequra nga të rinjtë, këshillave studentore, institucioneve të Kosovës, akterëve ndërkombëtarë dhe organizatave që bazohen në besim, në përpjekje për të krijuar mekanizma për paralajmërim të hershëm lidhur me parandalimin e radikalizmit që shpie në ekstremizëm të dhunshëm.
19. Të organizohen fushata në terren për rininë dhe nga rinia, duke përfshirë mes tjerash ligjërata joformale në shkolla, seanca trajnuese për parandalimin e radikalizmit të udhëhequr nga zyrtarët policorë, ngjarje të komunitetit në qendrat e komunitetit/hapësirat e përbashkëta, netët me filma tematikë, etj.

Duke pranuar se **arsimi** luan rol të paçmueshëm në parandalimin e dhunës kundër/në mes të të rinjve, ne ju bëjmë thirrje institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare të ndërmarrin masat vijuese:

20. Të trajtojnë mospërputhjet në mes të sistemit arsimorë të Kosovës dhe atij të Serbisë, dhe të ndërmarrin hapa për krijimin e një qasje gjithëpërfshirëse për historinë e Kosovës dhe proceseve aktuale.
21. Të mundësohet qasje në materialet arsimore në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.
22. Të sigurohen mundësitë për të rinjtë që në vendbanimet e tyre të mësojnë cilëndo nga gjuhët zyrtare në Kosovë pa pagesë.
23. Të nxitet bashkëpunimi në mes të Universitetit “Hasan Prishtina” dhe Universitetit të Prishtinës që ndodhet në veri të Mitrovicës, dhe të stimulojnë studentët nga komunitetet jo-shumicë të studiojnë në kolegjet dhe universitetet e Kosovës.
24. Të zhvillohet më tej arsimi për të drejtat e njeriut, me një përqendrim të fuqishëm në mësimin e diversitetit etnik, kulturor dhe religjioz në Kosovë, si element në kurrikulat shkollore, si dhe përmes arsimit joformal.
25. Të rritet cilësia e arsimit të mesëm dhe atij të lartë duke investuar në përshtatjen e metodave mësimore, në materialet moderne të mësimnxënies, dhe mundësitë për të ftuar ekspertë të jashtëm të ligjërojnë për tema specifike. Këta ekspertë, në mes tjerash, mund të vijnë nga KB-ja dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare që ndodhen në Kosovë, për të siguruar që të rinjtë janë të informuar në mënyrën e duhur për zhvillimet politike, ligjore, ekonomike dhe shoqërore, në pajtim me standardet evropiane.
26. Të përmirësohen metodat e vlerësimit në shkolla në pajtim me praktikat më të mira bashkëkohore, dhe të shqyrtohet heqja e sistemit të notimit në shkollat fillore, pas shembullit referent të modelit finlandez.
27. Të investohet në fuqizimin e kapaciteteve të të menduarit kritik në mesin e të rinjve dhe aftësinë e tyre për t’i rezistuar propagandës dhe lajmeve të rreme.



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

28. Të inkurajohet përgjegjshmëria e arsimtarëve me paraqitjen e një sistemi që studentëve do t'ju mundësonte të vlerësojnë punën dhe profesionalizmin e edukatorëve.
29. Të krijohet një mekanizëm që do të rriste përgjegjshmërinë dhe do të sfidonte korrupsionin në arsimin e lartë.
30. Të mbahet një fushatë mbarë kosovarë për vetëdijesimin e rreziqeve të kërcënimeve dhe kërcënimeve kibernetike dhe për mënyrat e reagimit ndaj kërcënimeve të tilla, të kombinuar me aktivitete arsimore joformale që në shënjestër kanë të rinjtë, prindërit e tyre, arsimtarët dhe psikologët e shkollave.
31. Duke ditur se të rinjtë janë të “lindur në kohën e digjitalizimit”, të arsimohen fëmijët dhe rinia për sjelljet e përgjegjshme në internet, si dhe për mënyrat e shmangies së përmbajtjeve dhe lojërave të dëmshme në internet.
32. Të sigurohet që çdo institucion arsimor në Kosovë të ketë psikolog, i cili është i aftësuar të reagojë në mënyrën e duhur në rastet e dhunës kundër/në mes të të rinjve në gjuhën përkatëse për një rajon të caktuar.

Duke ditur se **rreziqet që lidhen me ambientin përbëjnë një formë të dhunës ekologjike**, që është shumë e rëndësishme për Kosovën, ne kërkojmë që institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare të ndërmarrin masat vijuese:

33. Të avancohet infrastruktura dhe të rritet frekuenca e transportit publik, në mënyrë që të zvogëlohet shfrytëzimi i automjeteve private dhe taksive të vjetërsuara ilegale, duke u përqendruar specifikisht në udhëtimin në mes të viseve urbane dhe rurale.
34. Të konsiderohet shfrytëzimi i resurseve të qëndrueshme energjetike, siç janë energjia diellore dhe ajo e erës, për shembull për dritat e rrugës.
35. Të promovohen bursat dhe puna kërkimore në fushën e energjive të ripërtëritshme në Kosovë që në shënjestër kanë të rinjtë.
36. Të rritet vetëdija për sjelljet e përgjegjshme ekologjike në mesin e të rinjve dhe grupeve më të mëdha të popullatës në mbarë Kosovën, duke u përqendruar specifikisht në parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit tokës, dhe në riciklimin.
37. Të stimulohen organizatat që punojnë për riciklimin e mbeturinave në Kosovë, për shembull me reduktimin e taksave.

C. Mbrojtja

Duke e marrë parasysh paqen dhe sigurinë në një kontekst më të gjerë të **sigurisë njerëzore** dhe lirinë nga diskriminimi etnik, religjioz, gjinor dhe format tjera të diskriminimit, dhe qasjen e barabartë në shërbimet



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

sociale për të gjithë të rinjtë në Kosovë, ju bëjmë thirrje institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare të ndërmarrin masat vijuese:

38. Të trajtojnë shkaqet e pabarazive gjinore përmes fuqizimit të grave dhe vajzave të reja, dhe të rrisin vetëdijen për të drejtat pronësore të grave në mesin e grupeve më të gjëra të popullatës në mbarë Kosovën.
39. Të ndërmarrin masa specifike për të parandaluar punën e fëmijëve, dhe të hartojnë programe për trajtimin e braktisjes së shkollës.
40. Të ngritin vetëdijen për ngacmimet seksuale dhe për dhunën në baza gjinore në mesin e të rinjve, me përdorimin e mjeteve inovative siç janë aplikacioni i mobilit “Ec Shlirë” (“Walk Freely”).
41. Të mbështesin integrimin e të rinjve nga grupet e marginalizuara me ofrimin e stimulimeve më të mira për përfshirjen e tyre dhe me mundësimin e mësim-nxënies me dhe nga njëri tjetri, dhe fuqizimin e tyre përmes programeve të vullnetarizmit.
42. Të krijohet një ambient gjithëpërfshirës për të rinjtë me nevoja të veçanta. Në një perspektivë afatgjate, kjo mund të fuqizohet përmes sensibilizimit të studentëve të arkitekturës, atyre të planifikimit urban dhe administratës publike për nevojat e të rinjve me paaftësi.
43. Të fuqizojnë mekanizmat dhe strukturat që synojnë **parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna e të rinjve** me masat vijuese:
 - a. Fuqizimin e mekanizmave të drejtësisë për të mitur në Kosovë dhe ofrimin e trajnimeve përkatëse për zyrtarët policorë, për prokurorët dhe për punëtorët socialë me fokus të veçantë në rajonet e ndara në baza etnike;
 - b. Përfshirjen e fjalisë “dhuna kundër të rinjve dhe fëmijëve” si rrethanë rënduese në Ligjin e Kosovës për parandalimin e dhunës në familje.

D. Partneritetet

Duke ditur se rinia luan rolin e faktorit pozitiv të ndryshimit në përpjekjet për paqe të qëndrueshme në Kosovë, dhe duke qenë të vetëdijshëm për potencialin tonë të fuqishëm në krijimin e tregimeve pozitive të bashkëpunimit ndëretnik përmes mediave sociale, ne u bëjmë thirrje KB-së, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës të ndërmarrin masat vijuese:

44. Të sigurojnë dhe të përkrahin partneritetet me të rinj në lidhje me krijimin e politikave dhe programeve që prekin të rinjtë në të gjitha nivelet në institucionet e Kosovës dhe në organizatat ndërkombëtare.
45. Të shqyrtojnë mundësinë e përfshirjes së profesionistëve të rinj dhe studentëve si kontribuues në proceset e re-integrimit dhe stabilizimit, të drejtura nga prantëri ndërkombëtare dhe institucionet e Kosovës (siç është përfshirja e studentëve të drejtësisë në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në



**Konsultimi i Kosovës për studimin e
progresit të Sekretarit të Përgjithshëm
të KB-së për rininë, për paqen dhe për sigurinë**

28-29 qershor 2017, Prishtinë

gjykata, ose angazhimi i studentëve të linguistikës në përkthimin e dokumenteve në pajtim me Ligjin e Kosovës për përdorimin e gjuhëve).

46. Të krijojnë kushte dhe të përkrahin bashkëpunimin e të rinjve me institucionet arsimore, me OJQ-të lokale, me policinë dhe me forcën e sigurisë, me institucionet religjioze, me organizatat e bazuara në besim dhe me mediat, në përpjekje për parandalimin e radikalizmit në Kosovë.
47. Të ofrojnë mundësi për punë praktike me pagesë në institucionet e Kosovës, në agjencitë e mediave dhe në organizatat ndërkombëtare.
48. Të stimulojnë përfshirjen e të rinjve në fushatat e vetëdijesimit për parandalimin e të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë edhe dhunën ndërmjet të rinjve dhe radikalizmin, jo vetëm si marrës të informacioneve por edhe si akterë kyç në shpërndarjen e informacioneve në qarqet e të rinjve, në mes tjerash në mediat sociale.
49. Të ofrojnë mbështetje të nevojshme për krijimin e rrjetit joformal të të rinjve me prejardhje të ndryshme etnike nga mbarë Kosova, të cilët do të përfshihen aktivisht në aktivitetet përcjellëse mbi Udhërrëfyesin e Kosovës për rininë, për paqen dhe për sigurinë përmes bashkëpunimit me KB-në, me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet e Kosovës, për çështjet e implementimit të rekomandimeve dhe monitorimit të progresit në implementimin e rekomandimeve.
50. Të përfshijnë rekomandimet e Udhërrëfyesit të Kosovës për rininë, për paqen dhe për sigurinë në strategjinë e ardhshme të Kosovës për rininë dhe në planin e veprimit.

29 qershor 2017

Prishtinë, Kosovë